



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 91, datë 31.05.2021

**PËR
MARRJEN E MASAVE NDAJ “CREDINS INVEST-SHOQËRI ADMINISTRUESE TË
FONDEVE TË PENSIONIT DHE E ASETEVE TË SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2 dhe pikës 21, si dhe nenit 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 80, 81, 102 dhe 103 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Bazuar në nenin 80, pika 2 dhe nenin 81, pika 1, germa b), të Ligjit nr. 10197 datë, 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar”, urdhërohet shoqëria administruese “Credins Invest-Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit dhe e Aseteve të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a.:**
 - a. Të depozitohet menjëherë në Autoritet dokumentacionin e duhur për marrjen e miratimit të funksioneve të deleguara;**
 - b. Të depozitohet për miratim në Autoritet versionin e përditësuar të prospektit si dhe të publikohet në faqen e internetit versionin e fundit të miratuar nga Autoriteti;**
 - c. Të informohet çdo anëtar të fondit sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 14, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar”;**
 - d. Të përmirësohet procedurën për informimin dhe transparencën ndaj anëtarëve të fondit të pensionit;**
 - e. Të njoftohet anëtarët e fondit, 3 muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e asetëve neto në llogarinë e tyre të pensionit, sipas nenit 4, pika 2 dhe 4, të Rregullores nr. 126, datë 07.12.2010 “Mbi mënyrat, kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit vullnetar”;**

- f. Të ketë të detajuar në procedurën e saj operacionale, afatet dhe mjetet e komunikimit për informimin e anëtarëve në lidhje me ndryshimin e depozitarit të aseteve të fondit;
 - g. Të marrë çdo masë tjetër që lidhet me korrigjimin e shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit.
2. Bazuar në nenin 81, pika 3, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar”, shoqëria të zbatojë urdhërin e mësipërm duke raportuar në Autoritet brenda datës 30 qershor 2021.
 3. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave, për njoftimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE